



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI⁴⁷, mbledhja e 3) me dt. 23 .03.2021 (e martë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës Janar – Dhjetor 2020
4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Kastrioti " SH.A.
5. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq
6. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Mazgit
7. Kërkesat nga MPL, për rishqyrtim të vendimeve të Kuvendit komunal të dt. 29.01.2021 dhe atë:
 - a) Vendimi nr. – I - 09
 - b) Vendimi nr. – I - 10
 - c) Vendimi nr. – I - 11
 - d) Vendimi nr. – I - 12
 - e) Vendimi nr. – I - 13
 - f) Vendimi nr. – I - 14
 - g) Vendimi nr. – I - 15
 - h) Vendimi nr. – I - 16
 - i) Vendimi nr. – I - 17
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRQJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izleзна

Nr. -1- 41
Br.

Data 15.03.2024
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.26.02.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumljia (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Armend Rushiti (LB), Nora Preniqi (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, drejtorët komunal, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara:
3. Raporti vjetor i Kuvendit komunal
4. Plani i punës së Kuvendit komunal për vitin 2021
5. Bartja e mjeteve nga viti 2020 në vitin 2021
6. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-90, të dt.19.02.2021
7. Shqyrtimi i kërkesave të DKRS-së
 - a) Qendra rinore
 - b) Këshilli i veprimit rinor lokal
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi – Fillimisht kërkoj falje për vonesën e materialit, për një ditë për shkak të 2 raporteve si Kuvend, që i kemi nxjerrë. Mirëpo, siç e dini ky muaj ishte muaj zgjedhor dhe fillimisht më lejoni të uroj një përzgjedhje të qetë dhe të ndershme që e kreu Kosova. Shfrytëzoj rastin me urue edhe fituesin e këtyre zgjedhjeve, mbi të gjitha ka qenë një proces i rregullt dhe transparentë, fituesit i shkoftë mbarë, ndërsa të tjerëve suksese herave tjera.

Tani, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe kërkoi falje lidhur me përkthimin e materialit në gjuhën serbe sepse përkthyesi është në pushim vjetor.

Aziz Bici – Kryesues, faleminderit për urimin e fitores. Unë ju ftoj për bashkëpunim të vazhdueshëm, ashtu qysh kemi qenë të gatshëm për me bashkëpunue gjatë këtyre 3 viteve, ju ftoj të bashkëpunojmë edhe për Kuvendin komunal, gjithmonë për interes të qytetarëve, interes të vendit tonë, qysh janë punët më së miri që mund ti qojmë. Mendoj se rendi i ditës është voluminoz dhe ju thatë se është vetëm një ditë me vonesë, por unë mendoj se është më shumë se një ditë sipas Rregullores së punës sepse është dorëzue të hënën. Ndërsa, sot është e premtë si ditë që është brenda Rregullores, atëherë është prapë me vonesë sepse mendoj se është

më tepër se sa një ditë pune. Ne vazhdimisht do të reagojmë dhe nuk do të heshtim kur ju do ta vononi rendin e ditës, duke e shkelë Rregulloren.

Kryesuesi – Unë fillimisht kërkova falje dhe thashë se është një ditë me vonesë, për shkak se ishte muaj zgjedhor dhe Komisioni nuk ka mund ta bëjë planin e punës.

Aziz **Bici** – Unë them se ka më shumë ditë vonesë, e jo një ditë dhe kërkojmë që në të ardhmen kjo më të mos përsëritet.

Kryesuesi – Besoj se nuk do të përsëritet më sepse kemi marrë mësim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për e miratuan rendin e ditës të cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal ishin të pranishëm në mbledhje.

Pika 2 e rendit të ditës

Shaip Paloja – Paraqet vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar sepse në pyetjen e z.Aziz Bici, në seancën e kaluar kur jam përgjegjës unë duhet të përmirësohet në vend të fjalës “kandidatë” duhet të jetë fjala “mandate”

Anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht e miratuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjen e cekur më lartë.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi - Unë jam munduar me sjellë një raport vjetor të punës së Kuvendit komunal në pika të shkurtëra. Ne të gjithë e dijmë se viti 2020, ka qenë vit i pandemisë, i sfidave në ve çanti për Ekzekutivin. Sa i përket menaxhimit me Covid 19, duhet me falenderue shtabin emergjentë në krye me Kryetarin dhe Drejtoritë përgjegjëse për angazhimin maksimal për menaxhimin e pandemisë.

Tani, kryesuesi paraqiti raportin vjetor të Kuvendit komunal, në mënyrë detale.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Planin e punës të Kuvendit komunal për vitin 2021, në mënyrë detale.

Nazmi Gashi – Në këtë vit i kemi paraparë 2 vizita me planin e punës që duhet ti realizojmë. Unë i kam dhënë vërejtjet e mia rreth planit të punës të Kuvendit komunal. Po ashtu, ne anëtarët e Kuvendit komunal duhet të kemi një album të përbashkët sepse kemi punuar shumë vite së bashku.

Kryesuesi – Sinqerisht ka të drejtë z.Nazmi Gashi, dhe është mirë të gjithë të dalin në fotografi te Foto Agroni për me bë një pano. Në fund të fundit, ne mund ta bëjmë foton edhe këtu.

Ibush Mjekiqi – Mendoj se saktësisht me emër e mbiemër duhet të dihet cili nuk ka qenë me bë foto dhe ai le të shkoj sepse fotoja ndryshe delë atje për pano, e ndryshe delë këtu.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për Planin e punës të Kuvendit komunal për vitin 2021.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për një sqarim më detal rreth bartjes së mjeteve nga viti 2020 në vitin 2021, fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli – Të hyrat vetanake në vitin 2020, kanë qenë të planifikuara 1 milion e 20 mijë e 665 €, dhe kemi mund me i realizue 881,168.63, kështu që nuk kemi mund me përmbushë planin qysh ka qenë i planifikuar për shkak të pandemisë. Për bartjen e të hyrave vetanake i kemi 483,150.85 €, mallra dhe shërbime 138,548.29 €, shpenzime komunale 44,365.56 €, subvencione dhe transfere 150,173 €, investime kapitale 194,629.67 €. Nga ndriçimi publik 24,314 €, 5,088 €, shkojnë te ndërtimi i aneksit për arkivë, 19,226 €, te ndërtimi i bibliotekës. Te tabela rregullimi i parqeve, mua, më ka shpëtuar një gabim sepse nuk është rregullimi i parqeve, por rregullimi i kanalizimit 2,101.16€, kalon te asfaltimi i rrugëve. Hartimi i planit, 8,331.33 €, ndërtimi i bibliotekës, eksproprijimi 73,051 €, ndërtimi i shtatoreve në Obiliq 25.55.69 €, ndërtimi i bibliotekës 37,95.39 €. Te rregullimi i fushave sportive kanë mbetë 41,85 €, fusha e trashëgimisë kulturore 1,564.23 €, kalojnë në ndërtimin e bibliotekës brenda Drejtorisë. Sallat në SHLMP në Milloshevë 436,77 €, kalojnë te ndërtimi i anekseve shkollore 436.77 €, sepse ka edhe buxhet 21,250 €, që i ka në vazhdimësi pune.

Kryesuesi – Ne e dijmë se viti 2020 ka qenë viti i pandemisë dhe sfidave, por ne iu kemi ndihmuar edhe bizneseve për me kaluar krizën e pandemisë, e jo me i ndëshkue qytetarët. Ne e dijmë se për çdo vit është tejkaluar plani i të hyrave vetanake, por viti 2020, ka qenë vit i telasheve të mëdha dhe uroj që në këtë vit sa më pak të ketë njeëz të prekur nga Covid 19.

Lulzim Sadiku – Te bartja e mjeteve, vërtetë nuk është vetëm ky vit kalendarik që bëhet bartja, por fatkeqësisht kjo po ndodhë për çdo vit. Ne si opozitë gjithmonë do të kritikojmë sepse bartja e mjeteve në vlerën prej 483,150.85 €, nga të hyrat vetanake, ato tani po barten në vitin 2021. Gjithë këto mjete, që barten është dështim i planifikimit të Drejtorisë, që ka të bëjë me profesionistët e vetë, kur kësaj i shtohen dhjetëra e mijëra euro, që kanë shkue suficit atëherë kjo delë se është një shumë shqetësuese. Kjo, që po ndodhë për çdo vit vërtetë është për keqardhje. Të gjitha sektoret mos me mund me planifikue vitin kalendarik dhe me teprue mbi 40 % e buxhetit, është shumë shqetësuese. Nëse, e marrim nga viti kalendarik vitin 2019-2020, atëherë vërtetë, kjo është shumë e madhe e mjeteve për të cilën po flasim. Unë do të besoj se ky trend i dështimit të shpenzimeve të mjeteve do të ndalet sepse mosshpenzimi i mjeteve apo arritja mos me i shpenzue mjetet dhe ato me shkue në suficit, menjëherë e humbë kuptimin dhe rëndësinë e aprovimit të Ligjit të Obilëqit. Në fakt edhe pse jemi opozitë jemi të detyruar për shkak të interesave të Komunës tonë me votue, por mbi të gjitha këto janë dështime sepse është shumë e madhe e cila bartet. Sikur të ishte edhe ky vit i pandemisë, ne kishim me arsytue, por kjo po ndodhë për çdo vit jemi të obliguar edhe pse janë dështimet komunale, menaxhine të këqija me votue, përndryshe kemi shumë vërejtje sa që me u habitë them për secilën.

Enver Gashi – Ne jemi për bartjen e këtyre mjeteve.

Aziz Bici – Ne do të abstenojmë.

Nazmi Gashi – Drejtoreshë, ne 2 herë jemi takue, kam thënë për projektet që kemi bisedue dhe është mendue se do të kryhen, po e shohë se disa mjete i kanë marrë Ministrinë dhe Qeveria qëndrore. Prandaj, është mirë të dijmë se ku janë dhënë, për çka janë dhënë këto mjete dhe pse nuk janë kryer ato projekte në të cilat jemi orientue. Psh me bë një projekt dhe me qenë dallimi 30 %, ose 40 %, nuk është logjike, as e kapshme, nuk i afrohet as profesionalizmit, as nuk ka kuptim dikush me këtë me u marrë. Shpresoj se i përfundojmë projektet për të cilat kemi biseduar dhe mjetet që kemi thënë për Covid 19, me iu dhënë qytetarëve, mundësisht me na sqarue pak si qëndron çështja e tyre.

Qendresa Dubova – Pyeti pse në shëndetësi nuk është bartë asnjë mjet kur dihet se puna më e madhe është kryer në pandemi.

Ibush Mjekiqi – Përgjegjet se në shëndetësi nuk ka nevojë të barten mjetet, do të thotë ka mjetet të mjaftueshme. Unë nuk pajtohem se është qeverisje e keqe, se është dështim sepse jemi munduar që të bëjmë më të mirën të mundshme bashkarisht me ju. Viti 2020, ka qenë vit i pandemisë dhe në 3 mujorin e parë të vitit 2020, nuk është aprovuar buxheti në Kuvendin e Kosovës, që është një lloj pengese. Pastaj, është ndaluar aktiviteti i zhvillimit të procedurave të Prokurimit për projekte kapitale 3,4 muaj, ose është lejuar zhvillimi i procedurave emergjente për menaxhimin e situatës epidemiologjike në vend, që edhe kjo ka qenë pengesë. Po ashtu, shumë biznese nuk kanë pasë mundësi ti kryejnë obligimet e tyre ndaj Komunës. Vërtetë, na kanë mbetë disa projekte që është dashur të kryhen në vitin e kaluar që vazhdojnë tash në këtë vit dhe është biblioteka në qendër të qytetit, është salla e sporteve në shkollën “Pandeli Sotiri” dhe aneksi shkollor në Breznicë. Mendoj se është e pamundur të shfrytëzohet buxheti qind për qind dhe gjithmonë kemi pasë bartje të mjeteve. Kuvendi komunal në dhjetor e ka marrë vendimin për pagesë të mjeteve për personat e prekur me Covid 19, që besoj se brenda 10 dite në këtë vit do të kryhen obligimet ndaj tyre.

Hysni Mjeku – Kërkoj falje se në mbledhjen e KPF-së, në mënyrë telegrafike na ka ikë diçka. Këto 480,000 €, që po barten në këtë vit, unë kujtoj se ky Kuvend, Ekzekutivi dhe Kryetari i Komunës, duhet të përqëndrohen te fshati Graboc i Epërm, sepse atje kemi 2 ura të rrënuara dhe popullata ka vështirësi jashtëzakonisht të madhe. Unë kujtoj se këto mjete duhet ti planifikojmë dhe ti jepet përparësi këtij lokaliteti sepse vërtetë janë në gjendje të dobët. Unë kujtoj se kemi mjete të mjaftueshme dhe meqë, po fillon muaji mars, do të thotë punimet ndërtimore kanë mundësi me fillue. Prandaj, apeloj te ky Kuvend, te Ekzekutivi

dhe Kryetari që vërtetë, këtij lokaliteti ti dilet në ndihmë. Flas, për një lagje që absolutisht nuk ka qasje me kalie atë lum, sepse ura është e rrënuar totalisht ndërsa, pjesa tjetër është e thyer në mes, por që është e rrezikuar për atë popullatë. Apeloj edhe një herë të jeni në nivelin e përgjegjësisë dhe detyrave ju si Kuvend, ju si Ekzekutiv dhe Kryetari që kësaj radhe vërtetë, të na ndihmoni.

Ibush Mjekiqi – Përveç vitit 2020, që ishte vit shumë i vështirë edhe fillimi i vitit 2021, ishte vit i vështirë. Në fshatin Grabofc, ju e dini se janë të rrënuara 2 ura dhe ne e kemi bërë evidentimin e tyre. Po ashtu, Komisioni e ka bërë evidentimin e të gjitha dëmeve të shkaktuara gjatë vërshimeve në janar të këtij viti. Kompania është në përfundim të hartimit të projekteve për këto 2 ura, në fshatin Grabofc. Sipas parashikimeve, 2 urat mund të marrin rreth 300,000 €, dhe mjetet e bartura i kontribuojnë zhvillimit të këtij aktiviteti si dhe qasjen e banorëve në komunikacion. Unë ju ftoj që të votoni për bartjen e këtyre mjeteve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për dhe 4 vota abstenim e aprovuan Vendimin për bartjen e mjeteve nga viti 2020 në vitin 2021.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e Kryetarit të Komunës, nr.II.–90, të dt.19.02.2021, për shfuqizimin e vendimit nr.-01-81-2010, të dt.29.04.2010.

Lulzim Sadiku – Unë e lexova materialin dhe më është dukë jo në rregullë, pasi që ka filluar të ndërtohet nxemja qëndrore, që është në interes të qytetarëve. Mirëpo, më befason fakti se qysh fillojnë procedurat në një pronë të papërkthyer, qysh Zyra e Prokurimit dhe Zyra përgjegjëse fillojnë punën në një pronë, që në fakt është pronë e dikujt tjetër. Nëse, Kryqi i Kuq dhe lënda shkon në Gjykatë, atëherë qysh veprohet dhe si veprohet, do të thotë ajo punë prolongohet ose ngrihet për 2 arsye. Arsyja e parë mund të jetë sepse në bazë të financave, është premtue gjatë fushatës dhe nuk ka mundësi të kryhet dhe e dyta është se është bërë një marrëveshje. Nëse, është bërë marrëveshja që po thuhet se në mes të Kryqit të Kuq dhe Kryetarit të Komunës, është dashur të dihet se ku do të jepet parcela, kur i merret Kryqit të Kuq, vërtetë këto leje të ndërtimit ku brenda një viti është i obliguar operatori dhe qytetari që e merrë lejen të ndërton, që në fakt pajtohem plotësisht. Mirëpo, unë këtë do ta ngrija edhe për shumë prona tjera që kemi dhënë prona milionëshe, a kanë filluar prej vitit me krye punë sepse është çështje shumë madhore. Ajo që më preokupon është se në atë parcelë për të cilën po flasim është rregullue edhe një rrugë që shkon te Kurteshët. Nëse, e shikojmë prej gjeoportalit befashohesh sepse rruga është ndërtuar në parcelën për të cilën po flasim me nr.01-81-10, do të thotë se janë bërë shkelje pas shkeljeve. Shkelja e parë është se është ndërtuar rruga në këtë pronë, shkelja e dytë është se ka filluar puna e nxemjes qëndrore dhe tash pas 6 muajve po e marrim pronën. Mua, më befason fakti se qysh kanë mund organet përgjegjëse të Komunës, me thënë fillo ti punën në një vend ku në fakt nuk e ka pasë pronë të vetën. Meqë, nuk është Kryetari prezentë në mbledhje, kërkoj që kjo pikë të shtyhet deri në seancën tjetër sepse është e paligjshme, janë bërë shkelje, ka shumë paqartësi, rruga është bërë pronë e Kryqit të Kuq, puna ka filluar në pronë të Kryqit të Kuq, ndërsa ne sot kërkojmë me ia marrë për shkak se nuk e ka filluar punën. Kjo, për mua është paqartësi, prandaj unë jam që të shtyhet kjo pikë, ose do të votoj kundër për këtë çështje.

Fatos Kurshumlja – Edhe unë pajtohem me mendimin e z.Lulzim Sadiku, dhe e pata të njejtin mendim paraprakisht. Mendoj se ne po biejmë në lajthije se po na vjen me votue një pronë, me ia marrë atij, që mendoj se është dashur me ia marrë brenda 2,3 vjete, përderisa ai nuk ka filluar ndërtimin e depos në vitin 2021. Neve, po na vjen një kërkesë sot kur para 3,4 muajve, nuk po e di saktësisht është vënë gurthemeli në atë pronë për ngrohjen qëndrore.

Aziz Bici – Sipas materialit që na është ofru, thuhet se pas një viti që prona i është dhënë kompanisë në fjalë dhe e njëjta nuk është shfrytëzuar, komuna ka pasë të drejtë që të ja marrë. E kjo nuk është ba tash e 10 vjet. Domethanë edhe qeverisjet e kaluara nuk kanë qenë të interesume t'i zbatojnë rregulloret në fuqi. Masi që kjo nuk ka ndodhë deri tash, unë mendoj se në këtë mënyrë po i shkelim procedurat, prandaj do të abstenoj, nuk do të votoj as për, as kundër.

Armend Rushiti – Edhe unë jam i mendimit që kjo çështje të shtyhet për seancën tjetër, në mënyrë që të marrim informacione më të sakta dhe më bindëse, pse kanë ndodhë gjithë këto procedura, që në bazë të tyre

njëra pas tjetrës janë të kundërligjshme. Prandaj, mendoj se kjo pike duhet të shtyhet për në seancën tjetër, që ne të marrim informacione të sakta.

Nazmi Gashi – Është me rrëndësi se në këtë pronë ka filluar një projekt shumëi rrëndësishëm për qytetarët dhe përfundimi i këtyre punimeve sa kam parë unë aty, është në afatin i pakapshëm aty. Unë e di që z.Lulzim Sadiku, e dha një arsytim shumë të mirë, por po bëhen disa gabime nëse nuk merret vendim po mbesin disa telashe më të mëdha. Ju, si të doni mendoni por kjo ka me u krye.

Hysni Mjeku – Ne edhe në mbledhjen e KPF-së, kemi kërkuar informacione dhe kemi kërkuar që të jetë përfaqësuesi i Kryqit të Kuq këtu, prezentë. Tani, pse nuk është përfaqësuesi i Kryqit të Kuq, kur kemi të bëjmë me një projekt dhe me një vendim që e ka dhënë ky Kuvend. Mirëpo, duke i analizuar shumë gjëra sepse interesi public është më i madh, ne me vite kemi kërkuar që nxemja qëndrore aman të vjen në Obiliq dhe me rrethinë krejtë. Tash psh jemi kundër një projekti me interes public jashtëzakonisht madhor, që është interes i qytetarëve tonë dhe tash dalin informacione dhe mendime kundër kësaj. Unë nuk e kuptoj këtë farë gjjuhe, dikush ndoshta e kupton, por unë nuk po e kuptoj. Unë pjesërisht e kuptoj dhe jam pro këtij vendimi sepse vërtetë është një projekt në interesin e përgjithshëm dhe publik. Mendoj se ai që është kundër projektit të nxemjes qëndrore vërtetë, nuk mendon mirë për këtë popullatë.

Fatmir Bektashi – Dje, pas Komitetit gjatë pauses pata fatin e takova përfaqësuesin e sekretarit gjegjësisht të Kryqit të Kuq, qëndrës ku prezentë ka qenë edhe z.Lulzim Sadiku. Ata, kishin pasë një takim me Kryetarin, që gjatë atij takimi e kishin bërë një marrëveshje gojore dhe kjo marrëveshje është e pranuar. Unë po flas në emër të Kryqit të Kuq, dhe ndoshta, është e tepërt që kështu po flas, por e kam një shoqëri me sekretarin e Kryqit të Kuq. Ata vetëm po dojnë lokacionin e ardhshëm me gjetë, këtë ndërrim që kanë me bë, ata kërkojnë vetëm këtë me ua dhënë. Pra, për ata kjo marrëveshje është e pranueshme. Propozoj nëse, ka mundësi në zonat kadastrale ku kemi ne parcela 20 ari, 30 ari me ia dhënë Kryqit të Kuq.

Armend Rushiti – Së pari për qytetarët e Obiliqit për nxemje këtë largone prej mendjes. Ajo që më shqetëson mua është se qysh ka mundësi brenda një viti me u ndërtue rruga me asfalt dhe tash me ia ndërrue destinacionin për objekt të nxemjes, diçka që nuk është e logjikshme askund. Kjo, më intereson pse ka ndodhë që brenda një viti prej asfalti me kalue në objekt të nxemjes, kur kjo ka mund me fillue më heret

Aziz Bici – Ekzekutivi duhet me jep një arsytim se pse nuk është përsheptu ma herët ndërtimi i ngrohjes së qytetit. Na, të gjithë këtu jemi për të dhënë kontributin tonë, që sa më shpejtë me përfundu ndërtimi i ngrohjes qëndrore. Unë tash po ndërlidhem me parafolësin z. Bektashi, ju ende po pritni marrëvedhje me Kryqin e Kuq, por pas këtij informacioni për shfuqizim të vendimit për pronën e dhënë Kryqit të Kuq, nuk ka nevojë për marrëveshje. Këtu po mungon rekomandimi i zyrës për çështje ligjore. Ajo pronë duhet të mirret dhe nëse ata i plotësojnë kushtet, kërkojnë hapësirë tjetër, e atëherë mund të ua lëshojmë.

Ibush Mjekiqi – Në 2 vitet e fundit është punuar shumë në këtë projekt, ku janë zhvilluar 3 hapa të rrëndësishëm. Së pari, është bërë studimi i fizibilitetit, një hap shumë i madh për këtë projekt, së dyti është bërë hartimi i projektit detal dhe së treti është zhvilluar një procedurë e Prokurimit, për kontraktimin e kompanisë për ndërtimin e objektit të kogjenerimit. Shfuqizimi i vendimit për të cilin bëhet fjalë, nuk është i paligjshëm dhe unë nuk pajtohem me këtë sepse kjo pronë është pronë komunale. Ky Kuvend, ia ka dhënë pronën Kryqit të Kuq për ndërtimin e depos, por ata nuk e kanë shfrytëzuar atë të drejtë. Unë ju lus, që sot të merrni vendim për shfuqizimin e atij vendimi, ndërsa në seancat tjera do të gjejmë pronë sepse edhe Kryqin e Kuq, nuk do ta lejmë anash. Këtu, është edhe drejtori i DPUKP-së dhe kërkoj të japë sqarime kryesues për këtë çështje.

Arben Berisha – z.Lulzim Sadiku, e ke dhënë një informatë të gabueshme dhe është ndryshue edhe diskutimi komplet. Ju njoftoj se prona është komunale dhe nuk është pronë e Kryqit të Kuq. Këtu, po kërkohet shfuqizimi i një vendimi i cili e autorizon DPUKP-në, me dhënë leje ndërtimi. Sipas ligjit nëse, brenda vitit nuk ekzekutohen punimet, ligji vetë e shfuqizon. Unë i kam propozuar Kryetarit se nuk ka pasë nevojë me bë kërkesë sepse vetë ligji e shfuqizon, por pasi që kjo çështje ka kalue përmes Kuvendit, është më e rrugës që prapë të kaloj përmes Kuvendit me shfuqizue vendimin.

Lulzim Sadiku – Unë nuk ia ndryshova bisedës kahjen, por i thashë ato që i di. Ju po thoni se prona është komunale, nuk është pronë komunale sepse po duhet me kthye në pronë komunale se po votojmë, është

pronë e Kryqit të Kuq, me vendim që e keni dhënë më heret. Pra, derisa po duhet me ia marrë pronën dihet se ajo pronë është e tij, e jo e jona. Prona është pronë komunale e Kryqit të Kuq, e jo e jona, por duhet me ia marrë. Unë bisedës kahjen nuk ia ndryshova, por e thashë në mënyrën më të rregulltë, që është e mundshme. Mua, më befason fakti se fillohet me një pronë pa fletë poseduese në vlerën prej 36 milionëve, vërtetë ndoshta është dashur që krimet e rënda të merren me Zyren e Prokurimit, me atë që e ka sjellë projektin për me fillue një punë kaq madhore në tokë të huaj, që është me të lënë mendët. Këto, janë skandaloze për Drejtorinë dhe Zyren e Prokurimit, punohet paushall dhe pasi që kryhen punët pas 6 muajve, delë në media dhe thotë merrja pronën.

Hysni Mjeku – Mua, pak po më brengosë se po flitet fjala akuzë sepse fjala akuzë është shumë e rëndë në aspektin juridik dhe unë nuk dua që atë fjalë me përdorë ne si Kuvend. Vërtetë, nga ky Kuvend nuk duhet me dalë se ne jemi kundër Kryqit të Kuq sepse ky Kuvend, i ka dhënë Kryqit të Kuq hapëirë të veprimit dhe jo vetëm Kryqit të Kuq, por edhe shumë shoqatave tjera, joqeveritare. Prandaj, të nderuar anëtarë të Kuvendit, unë jam gjithmonë për interesin publik sepse duhet të votohet dhe të aprovohet. Ne i kemi dhënë pronë Kryqit të Kuq, por kjo ka stagnue qe 10 vjet, do të thotë jashtë çdo normales. Prona është e Komunës, interesi është i qytetarëve dhe unë apeloj që ju menjëherë ta aprovoni një vendim të tillë. Ndërsa, Kryqit të Kuq ne kemi hapësira dhe mund të ia gjejmë një lokacion dikund në periferi. Prandaj, meqë është interes i përgjithshëm publik, atëherë urdhëroni anëtarë të nderuar të Kuvendit komunal dhe ta votojmë sepse është interesi ynë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për, 2 vota kundër dhe 3 vota abstenim e aprovuan Vendimin për Shfuqizimin e vendimit nr.01-81-10, id t.29.04.2010, për arsye se me këtë vendim i është ndarë për ndërtimin e depos Organizatës Humanitare “Kryqi i Kuq” parcela 210 në sipërfaqe prej 20 ari në lokacionin pranë shkollës së re fillore te lagjja e Hashanëve.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet rekomandimin e 5 të KPF-së, për mos shqyrtim dhe mos aprovim të kërkesave të DKRS-së, të Qendrës rinore dhe të Këshillit të veprimit rinor lokal. Ne në mbledhjen e KPF-së, u dakorduam që të mos shqyrtohen dhe mos të votohen këto 2 kërkesa, le të shkojnë sipas thirrjes publike për planin e vet të punës sepse Ministria në vitin e kaluar na i ka kthye dhe nuk kanë nxjerrë modalitet tjetër.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës, nr.-II-96, të dt.24.02.2021, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale, në zonën kadastrale në Obiliq.

Aziz Bici – Unë e di se është pezullue, prej AKP-së.

Ibush Mjekiqi – Po është pezullue, por me hapë rrugë që me bë pronë komunale.

Arben Berisha – Ne kemi bërë një reagim, kemi bërë shkresë dhe i kemi njoftue që në seancën e radhës në Kuvend, do të propozojmë me shpallë zonë me interes të përgjithshëm publik dhe jemi të interesuar prapë me shpronësue. Pra, kjo do të jetë pjesë e pasurisë komunale dhe do të bëhet zgjerimi i sheshit “Adem Preniqi”. Kjo është informata për pompën e derivative.

Labinot Mirena – Pyeti se a keni ndonjë dokument ta lexojmë para se ne të votojmë sepse pas votimit s’kemi më çka lexojmë.

Arben Berisha – Përgjegjet se ne kemi sjellë edhe kërkesa tjera, për me i shpallë zonë me interes të përgjithshëm, që nuk janë përfshi në privatizim dhe pse mos me i shpronësue Komuna, është një çmim i mirë dhe mbetet pasuri e Komunës.

Aziz Bici – Hartat nuk na i keni dërgue.

Kryesuesi – Hartat jo.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, ne e kemi biseduar çështjen e pompës edhe më heret që ka qenë kërkesë e Kryetarit. Unë jam pro kësaj kërkesë sepse është në interes të qytetarëve, janë çështje që në njëfarë mënyre ofrohet një projekt, që në të ardhmen me qenë pjesë e jona. Ne e dijmë se njëherë janë ngri aktivitetet, por unë jam pro sepse fillojnë procedurat që mos me mund me u shitë. Pra, edhe çështja e sheshit hyn aty, që nëse shiten me qenë pjesë e Komunës në interes të qytetarëve, kështu që jam pro dhe votoj për këtë vendim.

Aziz Bici – Siç është thënë më heret ne kemi diskutue dhe nëse, nuk gaboj e kemi votue njëherë.

Kryesuesi – Këtë parcelë jo.

Aziz Bici – Edhe unë jam i mendimit që ajo pompë e benzinës të shpronësohet, për shkak se nuk e ka vendin aty. Unë kërkoj që të pritet krijimi i qeverisë së re, për me pa se çka do të bëhet me AKP-në, si dhe nuk ka mundësi askush me ble para se me marrë pëlqimin e Kuvendit Komunal. Pra, pa e marrë vendimin nga kuvendi komunal, nuk mundet askush me ble. Për këtë propozimi im ishte që ta shtyejmë dhe të shohim se qysh do të vendoset për AKP-në.

Nazmi Gashi – Ajo është pronë në zonën e parë urbanistike dhe ne njëherë e kemi marrë një vendim për zonën e parë urbanistike, por duhet me i bërë të gjitha ndryshimet që i kemi paraparë. Tash, a është pompë e benzinës apo jo, ne kemi marrë njëherë vendim dhe është kryer ajo çështje.

Kryesuesi – Sqaron se për këtë parcelë nuk kemi marrë vendim sepse ka pasë çmim tjetër dhe nuk e kanë pasë në likuidim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për e aprovuan Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Obiliq.

Kryesuesi – Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës, nr.-II-97, të dt.24.02.2021, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale, në zonën kadastrale në Plemetin.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Pyeti se a janë 3 ari e 10 m².

Kryesuesi – Përgjegjet se janë 310 m².

Lulzim Sadiku – Unë do të jem për, por te këndi i lojërave te trafoja nuk po mund ta paramendoj.

Kryesuesi – Sqaron se trafoja do të rregullohet dhe izolohet.

Aziz Bici – Ne nuk e kemi të qartë se çfarë projekti do të jetë aty. Unë i kam lexuar të gjitha kërkesat e Kryetarit dhe asnjë nuk është e definuar se për çka do të përdoret.

Kryesuesi – Sqaron se kjo është një kërkesë e komunitetit për vendosjen e trafos dhe lokacioni për vendosjen e trafos është kjo parcelë 3 ari e 10 m², që figuron në emër të KBI-së, Kosova export dhe është menduar me vendosë trafon dhe me bërë një kënd të lojërave. Kjo parcelë mund të dalë me privatizim dhe për mos me dalë me privatizim duhet me shpallë zonë me interes publik, Komuna e blen nëse bëhet me një çmim simbolik 20 %, sa mund ta ketë AKP-ja, dhe i mbetet komunitetit, e jo neve.

Aziz Bici – Unë po e shfrytëzoj rastin edhe për kërkesat në vijim, që sigurisht se kryesuesi do të kërkoj miratimin. Së pari, neve nga materiali i mbledhjes nuk na janë dorëzue hartat se ku gjenden këto zona, as të kësaj kërkesë, as të kërkesave tjera, që mendoj se është dashur të na dorëzohen, që ne të dijmë se ku gjenden këto prona. Tjetra, është se është dashur të dihen se për çka definohen këto shpronësime. Për këtë arsye po them ta shtyejmë për mbledhjen e ardhshme, që ta kompletimi materialin, që të dijmë se çka po definojmë dhe të japim kontributin e nevojshëm për këto kërkesa.

Kryesuesi – Sqaron se në mbledhjen e KPF-së, i kemi kërkuar hartat dhe unë kërkoj falje se sot na i kanë sjellë, por me i skenue me A3, ishte problem për me ua dërgue juve në email.

Aziz Bici – Këtu u tha që këto prona po shpronësohen për interesin e komunitetit, por ne jemi dëshmitarë që këto prona pas pak kohe, po ju ipen të tjerëve për shfrytëzim për 99 vite. Këtë e dini edhe ju, e dini se për të gjitha pronat që ipen për 99 vite, ne kemi qenë kundër dhe a është mirë, apo keq mbetet në të ardhmen të shihet. Mirëpo, unë po them na jepni kohë, na i dorëzoni hartat, te analizojmë dhe ta japim kontributin në seancën e ardhshme.

Kryesuesi – Këto, nuk kanë me iu dhënë askujt, por kanë me mbetë në emër të shfrytëzimit të hapësirës publike dhe asgjë më shumë.

Ibush Mjekiqi – Këtu, bëhet fjalë për ndërtimin e një trafoje, e cila do të shërben për furnizim me rrymë për të gjithë banorët e zonës. Procedura është e njejtë sikurse te pompa e benzinës dhe nuk ka nevojë me shtye këtë çështje.

Nazmi Gashi – Ne askujt nuk po ia japim, por po e marrim për vete.

Aziz Bici – Po, ashu është por pas disa muajve, po e jepni.

Kryesuesi – Sqaron se këtë po e marrim për vete dhe nuk mundesh me ia dhënë askujt sepse 3, apo 4 herë sipas procedurës duhet të votohet në këtë Kuvend, për me ia dhënë dikujt.

Armend Rushiti – Meqë, këtë po e marrim për vete, por çka u bë me çështjen e zonës që e shpallëm me interes publik në Bakshi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 3 vota abstenim e aprovuan Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Plemetin.

Kryesuesi – Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës, nr.-II-98, të dt.24.02.2021, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Obiliq.

Arben Berisha – Këtu, i kemi varrezat e qytetit dhe i kemi te lagjja Aliu, disa parcela me i shpallë zonë me interes të përgjithshëm, me hy në çështje të shpronësimit, me i kthye pronat në prona komunale dhe me investue për komunitete si te varrezat, ashtu edhe te lagjja Aliu.Kjo specifikohet për interes të komunitetit.Neve, na janë ofruar dje hartat, dje i kam printu dhe sot në në mëngjez i kam sjellë sepse nuk pati kohë më shumë.

Aziz Bici – Pyeti pse po na e sjellni këtë rend dite aq të ngarkuar, vetëm me thënë shkel e shko.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, jam pro kërkesës për varrezat me prolongue derisa të bëhet një zgjidhje, që Komuna të bëhet pronar i asaj pjese. Mirëpo, për tokën që po flasim është mirë që te Agjensioni i privatizimit me i marrë të dhënat e sakta sepse vala e fundit e privatizimit, për këtë pjesë që po flasim është e shitur. Unë jam tepër i sigurtë për pjesën që po flasim te lagjja Aliu, prapa asaj pjese, kjo pjesë është e shitur. Prandaj, duhet të marrim të dhëna të sakta, e jo të marrim vendime. Unë jam pro çështjes së varrezave sepse çka është në interes të Komunës dhe qytetarëve gjithmonë jam pro, por për pjesën që po flasim unë ju garantoj është mirë të merren të dhënat sepse është

çështje e përfunduar në valën e fundit të privatizimit. Nëse, nuk gaboj vala e fundit ishte para 7,8 muajve dhe është çështje e përfunduar për pjesën që po flasim. Kërkoj, drejtor që të merren të dhënat e sakta sepse ndoshta, nuk është kthye nga vala e privatizimit dhe nuk është përfundue dokumentacioni, por pagesa dhe puna për atë pjesë ka përfunduar. Unë jam shumë i sigurtë për këtë çka po flas.

Aziz Bici – Çdo gjë që kërkohet për komunitete, ne do të votojmë për, por do të jemi kundër që të përgatitet çfarëdo sipërfaqe e tokës, e cila sot fillon dhe përgatitet ndërsa, në të ardhmen jepet në shfrytëzim për 99 vite.

Kryesuesi – Ne nuk kemi përgatitë asgjë dhe nuk ka të bëjë fare me atë.

Arben Berisha– Unë flas me fleta poseduese dhe me kopje të planit, që i kam dokumentacion në kadastër me lëndën, që e kemi sjellë deri këtu. Sikur të ishte tokë e shitur ne nuk kishim me sjellë këtë çështje në Kuvend, për me shpallë zonë me interes të përgjithshëm. Krejtë dokumentacionin që ne e posedojmë në Komunë, është pronë e evidentuar me numër të parcelës, me titullar, me të gjitha i keni të sqaruara. Edhe një herë po them se këtu, nuk ka lajthitje sepse unë flas me përgjegjësi.

Hysni Mjeku– Edhe në mbledhjen e KPF-së, është diskutue kjo

çështje për me ardhë në Kuvend sepse kemi informacione dhe drejtori sikur nuk ka informacione ndaj Agjensionit të privatizimit. Mirëpo, duhet me i marrë informacionet sepse vala e fundit këtë pjesë e ka shitë. Sipas informacionit që kam unë, pronari i ka ble ato parcela dhe ne jemi shumë të vetëdijshëm në këtë drejtim se çka po diskutojmë. Tani, për këtë pikë që është hapë diskutimi, kërkoj nga drejtori të na japë raportin nga Agjensioni i privatizimit sepse ne mund të dalim si Kuvend, jo serioz. Unë nuk e di pse ju mos me pasë informacion, a e keni informacionin, vala e fundit kur është shpallë dhe unë po të garantoj se është e shitur. Prandaj, mos të dalim ne jo serioz duke marrë vendim për këtë çështje.Drejtori e ka gjendjen faktike të vjetër, por nuk e ka të valës së fundit, që është shpallë dhe është shitë. Kërkoj që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme dhe të merret raporti.

Ibush Mjekiqi – Mendimi im është nëse, pajtoheni që për pjesën e varrezave ku janë zonat kadastrale të fillohet ndërsa, për pjesën tjetër të merren informatat e sakta dhe të vendoset në seancën e ardhshme.

Lulzim Sadiku – Unë pajtohem plotësisht me Nënkryetarin, që me marrë vendim për çështje të varrezave sepse isha pro. Unë kërkoj falje nëse nuk jam, por jam i saktë se ajo pjesë është shitë në valën e fundit/ Nëse, nuk janë këto prona për të cilat po flasim do të kërkoj falje sepse jemi njerëz, por jam i sigurtë qind për qind se ajo pjesë është shitë. Unë pajtohem që për varrezat me marrë vendim në mbledhjen tjetër dhe ishalla është e pa shitur dhe marrim vendim në mbledhjen tjetër.

Ibush Mjekiqi – Tash, po krijon pasiguri, nuk ke siguri të plotë që është shitë.

Shaip Paloja – Për të gjitha këto prona që u diskutua edhe më heret dhe tani, po diskutohet për prona që nuk janë prona komunale. Mirëpo, po e shpallim një zonë me interes, ose po e trasojmë një rrugë që Komuna jonë në të ardhmen me i rikthye, ose me i bë prona komunale. Prandaj, duhet me kuptue për çka po flasim. Tash, po diskutohet për një pjesë që është zyrtare, që po thotë drejtori dhe për një pjesë kanë thënë, ose i kam thënë. Ne nuk e dijmë se AKP-ja, a e ka privatizue, ose së paku para neve nuk kemi diçka zyrtarisht prej AKP-së, për pronën e fundit. Drejtori neve, na ka sjellë diçka që është zyrtare dhe ai që e ka Privatizue, mendoj se duhet me ardhë në Komunën tonë me marrë fletën poseduese dhe të gjitha tjerat. Pra, është ana zyrtare dhe ana tjetër unë i kam thënë dhe ai më ka thënë. Unë e di se AKP-ja, nuk na përgjegjet neve, as Komunës, as Kuvendit komunal, i përgjegjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, ose Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mirëpo, ajo çka është e jona ne duhet me marrë një vendim dhe me shpallë zonë me interes, së paku a po e shihni se Komuna jonë shpeshherë nuk ka vend as për varreza, e le më për gjërat tjera. Hajde i kthehemi anës zyrtare dhe nëse, ne i kthehemi anës zyrtare, ne nuk gabojmë edhe nëse, e shpallim zonë me interes për Komunën tonë, asnjë gabim nuk jemi duke e bërë hiç. AKP-ja, nëse në të ardhmen sjellë diçka te drejtori atëherë, sigurisht se drejtori neve do të na njofton në të ardhmen.

Hysni Mjeku – Ne propozuam që ta shtyejmë këtë pikë, që Kuvendi vërtetë të jetë ashtu siç i ka hije në nivelin e duhur dhe nuk po humbim kohë kurgjë. Te varrezat, ne kemi qenë pro dhe jemi çdo herë pro, por këtu nuk është problem i madh që drejtori me marrë raportin prej Agjensionit, vetëm me thënë vala e fundit në pjesën kadastrale të Plemetinit, a është shitë, apo nuk është shitë. Tash, psh bjen keq nëse marrim vendim kur faktikisht prona është shitë. Mos ta ulim nivelin e diskutimit deri në atë nivel që vërtetë këtu, me qenë cirkus. Unë po them edhe njëherë se vala e fundit ka gravitue në Plemetin dhe nuk e di unë a është shitë, apo nuk është shitë, por unë po them se është shitë. Tash, a është shitë ajo, apo jo drejtori në bazë të raportit që e merrë është e qartë.

Nazmi Gashi – Nëse, Agjensioni i privatizimit i shet pronat e Komunës, dhe nuk dërgon kurrfarë njoftimi, kurrfarë raporti në Komunë, atëherë krejtë pronat që i ka shitë me mund ia marrë sepse është në territor të Komunës, patjetër duhet me na njoftue. Prandaj, mos të humbim shumë kohë krejtë atë për çka nuk na njofton Agjensioni neve për pronat, me mund sot ia marrë krejtë komplet.

Labinot Mirena – Nëse, sot ne nuk marrim vendim për këtë pjesën që është diskutabile se a është shitë apo nuk është shitë, nëse ndodhë që brenda 10 dite e qet AKP-ja, në privatizim a ka mundësi dikush me ble menjëherë, pa na ardhë neve radha e mbledhjes së Kuvendit komunal.

Hysni Mjeku – Po, mundet me ble.

Labinot Mirena - Prandaj, ne e votojmë sot në bazë të këtij dokumentacioni që e kemi, a e ka ble ky apo ai, ne nuk e dijmë, por ne e votojmë sepse për neve toka është e bardhë, nuk ka pronarë në bazë të dokumentacionit të drejtorit. Nëse, nesër delë privatizimi dhe e merrë dikush tjetër, atëherë ne nuk kemi mundësi as me marrë, ose duhet me ble te i njejti pronarë qysh i kanë ble tokat nga 20 €, ndërsa ne me ble nga 3,000 €, ne nuk kemi mundësi. Prandaj, unë ju bëjë thirrje të gjithë anëtarëve të Kuvendit, me votue këtë çështje.

Kryesuesi – Unë i di shqetësimet e të gjithëve këtu, por ne po dojmë me kthye në pronë komunale. Ky Kuvend, ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme në vitin 2010, për me ndalë privatizimin në Milloshevë, 400 ha. Atëherë, nuk ka pasë ligj, por tash Ligji për vetëqeverisjen lokale dhe Ligji për dhënien e pronave në shfrytëzim dhe këmbim, ia jepë mundësinë Asambleve komunale, me kthye pronën. Këto, parcela nuk do të jepen në shfrytëzim, por do të jepen vetëm për komunitete.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, u ndjeva keq, që po thojnë po flet paushall dhe unë nuk po flas paushall. Mirëpo, qëllimin e krejtë kësaj e pata se është vala e fundit ajo pjesë dhe e di saktë, tash mund të jetë ajo pronë apo

nuk mund të jetë, e di që është shitë në Plemetin, është shitë edhe lagjja Aliaj. Unë kërkova për një muaj sepse njëherë është ngri aktiviteti i shitblerjeve, vjen Qeveria e re dhe ndoshta ndryshojnë edhe Rregulloret, kështu që nuk kemi mundësi ne me bë hiç. Unë vetëm kërkova mos me dalë humor Kuvendi, në mënyrën më miqësore, isha pro pronave që me u kthye në interesin komunal, por isha kundër kësaj që të verifikohet për një muaj. E qartësoi edhe z.Mjekiçi dhe Nënkryetari, që të shtyhet deri në mbedhjen tjetër dhe ishalla delë që nuk e ka ble dikush. Përndryshe, kur janë pronat komunale, unë bukur shumë jam i thukët, bukur shumë e ngriti zërin dhe nuk jam ndër ata që mundohem me dhënë aq lehtë. Ne nuk po flasim paushall, por deri tash në këtë Kuvend, kam pasë arsye kur kam folë dhe gjithmonë kanë dalë arsyet e sakta. Prandaj, asgjë tjetër nuk po kërkoj vetëm se çështjen te varrezat e votojmë, ndërsa pjesën tjetër e shtyejmë për seancën tjetër.

Arben Berisha – Ju, e bëtë një gabim dhe the që është zona e Kryqit të Kuq, që mund ta dëshmoj me fletë poseduese dhe me të gjitha. Tash, po ta përkujtoj edhe njëherë se të gjitha këto që ne i kemi shenue, i kemi nxjerrë me fleta poseduese dhe kopje të planit. Ju, që doni me shtye këtë çështje shtyne, unë do të ju sjellë dokumentacion shtesë prapë megjithatë, unë këtu mbaj përgjegjësi sepse kam shenuar diçka.

Lulzim Sadiku – Tash, ka një vit drejtor që kam thënë se rruga Plemetin-Hamidi, është e ndërtuar në trase të huaj dhe ka dalë e saktë se ajo trase ka dalë në emër të qytetarëve, e jo rruga që ka qenë. Unë e kam thënë në mënyrë miqësore dhe Kryetari ka thënë po ashtu është. Edhe për çështjen e vendimit derisa vendimi shkruan në emër të Kryqit të Kuq, unë gjithmonë e njohë, derisa e bën ndryshimin dhe votimin nga Kryqi i Kuq, në pronë komunale, dua ta shohë që më bindë ajo zonë komunale, sepse nuk është dashur me ardhë si vendim hiç. Ne kërkuam që të shtyhet për seancën tjetër e ishalla nuk është shitë, por po dyshojmë se është shitë sepse ka qenë në rrjetet sociale, ka qenë në gazetë zyrtare që është shitë.. Unë do të jem kundër sepse jam i saktë dhe po them se te lagjja Aliu, është shitë.

Aziz Bici – Drejtori duhet të marrë informata shtesë për privatizimin apo mos-privatizimin e kësaj prone. Deklaratat e zëdhënësit të AKP-së, sipas mediave, janë se është ndërprerë privatizimi i pronave. Arsyetja pse ju e bëni këtë është se unë mendoj se në të ardhmen Qeveria do të marrë vendime, që do të jenë edhe më shumë në interes të Komunës. E vetnja arsye është që ju gjatë kësaj kohe deri në seancën e ardhshme ti merrni informatat e mjaftueshme sepse ju e dini se edhe 2 javë ditë, sigurisht se do të formohet Qeveria, institucionet prandaj ne kemi kohë të mjaftueshme, që mos me ardhë deri te ai rrezik që ne po dyshojmë se është privatizuar.

Kryesuesi - Tani, votojmë vetëm për pjesën e varrezave.

Aziz Bici – Duke e marrë parasysh se 24 ha, janë sipërfaqe shumë e madhe, unë mendoj që nëse bëhet e mundur që disi kjo sipërfaqe të shfrytëzohet para se të përdoret për varreza, atëherë jam pro.

Ibush Mjekiçi – Ne nuk kemi mund ta zhvillojmë aktivitetin për ndërtimin e parkingut para varrezave për shkak të pronës, as nuk kemi mund me parapa një objekt të kogejnerimit, prandaj ju lus të votoni.

Kryesuesi – Tani e hudhi në votim vetëm pjesën e varrezave, ndërsa për pjesën tjetër mbetet të na njofton drejtori i DPUKP-së.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për dhe 1 votë kundër e aprovuan Vnëdimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik vetëm për pjesën e varrezave për parcelën kadastrale, në zonën kadastrale në Obiliq.

Kryesuesi – Paraqiti Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës, nr.-II-99, të dt.24.02.2021, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në Mazgit.

Arben Berisha – Sqaron se ne kemi menduar që të hyjmë në valë të privatizimit të shpronësimit si Komunë dhe me i marrë këto parcela që janë përreth, me përjashtim të shtëpive dhe objekteve që janë. Mirëpo, edhe ato objekte janë në emër të Ramiz Sadikut, por ua kemi dhënë mundësinë pasi që është ligji në avansim e sipër për privatizim të drejtë përdrejtë të pronarëve, që kanë qenë më heret. Këta të gjithë janë shfrytëzues, por dokumentacione nuk kanë, do të thotë dokumentacioni është pasuri e Ramiz Sadikut. Ne këtu nuk i kemi përfshi në zonën me interes të përgjithshëm.

Kryesuesi – Unë flas për dokumente, që na i ke dorëzue zyrtarisht.

Arben Berisha – Unë i kam edhe 3 tjera, dhe kryesuesi nuk i ka pranue se i kam sjellë me vonesë, fjala është për 2,3 objekte të demoluara në të cilat nuk banon askush dhe kishte me qenë mirë me i shpronësue, me u bë pronë komunale, megjithatë do ti sjellim në javën e ardhshme.

Kryesuesi – Unë nuk pranoj dokumente shtesë, nëse në KPF çështja ka kalue pa dokument dhe ju ato mund ti sjellni në mbledhjen e radhës.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Aziz Bici – Ne do të abstenojmë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 3 vota abstenim e aprovuan Vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në Mazgit.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga DKA-ja, për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve për SHFMU “Pandeli Sotiri” në Obiliq dhe SHFMU “Hasan Prishtina” në Milloshevë.

Enver Gashi – Ne jemi për marrjen e këtij vendimi.

Lulzim Sadiku – Unë s’po e kuptoj pse Kuvendi me vendosë.

Aziz Bici – Kërkoj që të shtyhet formimi i Komisionit, pasi të fillon punën Qeveria në ardhje sepse kjo Qeveri në shkuarje, mendoj se nuk i plotëson kushtet për me sjellë anëtarin e tretë që parashihet sipas Udhëzimit Administrativ. E vetmja arsye është se deri më tash drejtorët dhe zëvendës drejtorët janë përzgjedhë ata persona që janë të dëgjueshëm me pushtetin dhe për këtë arsye ne e kemi gjendjen aq të keqe. Me shpresë se anëtari i tretë në të ardhmen nga Qeveria në ardhje do të jetë me ndikim që të respektohen kriteret sipas Udhëzimit Administrativ, unë kërkoj që krijimi i këtij Komisioni të shtyhet pasi që të formohet Qeveria.

Ibush Mjekiqi – Konkursi është shpallë dhe ka afat kohor se kur duhet të realizohet. Kjo, nuk ka të bëjë as me Qeverinë në shkuarje, as me Qeverinë në ardhje, sepse personat janë shërbyes civil të cilët janë të angazhuar në Ministri dhe nuk varet prej faktorit politik. Prandaj, Komisioni nuk duhet të shtyhet, por duhet të formohet prej 2 anëtarëve, ndërsa për anëtarin e 3 na njoftojnë me shkresë nga Ministria.

Aziz Bici – Unë jam i vetëdijshëm se ministri i Arsimit, nuk e delegon anëtarin e tretë, por ne kemi përvojë dhe s’mundemi me i tregue njëri tjetrit hiç ndryshe sepse deri më sot përgjegjësi dhe raport iu kanë dhënë liderëve politik dhe nuk i kanë dhënë atij profesional. Ne i kemi disa përvoja dhe e dijmë se kush janë edhe Ushtrues Detyre në këto shkolla, prandaj po them se ne mund të arsyetohemi sipas Udhëzimit Administrativ, por gjendja reale në terren është ndryshe. Do të thotë se jemi dëshmitarë të asaj se kryesisht, nuk po them të gjithë, por kryesisht përzgjedhen njerëz të cilët janë të dëgjueshëm të pushtetit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 1 votë kundër e aprovuan Vendimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve sipas Udhëzimit Administrativ të MASH-it, nr.151/2020, neni 3.1, për shkollat SHFMU “Pandeli Sotiri” në Obiliq, pozita: Drejtor, SHFMU “Hasan Prishtina” në Milloshevë, 1.Pozita: Drejtor, 2.Pozita: Zëvendës drejtor dhe SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” në Obiliq, pozita: Zëvendës drejtor.

Komisioni formohet me këtë përbërje: 1. Fatime Pllana, 2.Bashkim Ismajli dhe 3.Anëtar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Kryesuesi – Ju njoftoj se në KPF, e kemi pasë kërkesën për rrimërimin e SHF në Milloshevë, nga familja Morina dhe ne ia kemi dërguar DKA-së, për shqyrtim. Po ashtu, e kemi pasë edhe kërkesën nga Handikos-i, të cilën ia kemi dërguar DSHMS-së, për shqyrtim. Ju njoftoj se i kemi disa vendime të cilat duhet të rishikohen sepse po na prishin performancën zyrtarët e administratës për gabimet eventuale teknike që po i bëjnë. Neve, na janë kthyer të gjitha vendimet e pronave nga MPL-ja, për arsye se i mungon një dokument dhe përgjegjësinë e mban Drejtoria e cila i ka sponsorizue. Secilit vendim i mungon një dokument qarkulli bankar, plani dinamik, ose ndonjë vërtetim. Tash, kërkojen të rishikohen të gjitha këto vendime prapë në Kuvend dhe të pajisen me dokumente shtesë.

Arben Berisha – Sqaron se ne e kemi ofertën të prezentuar sepse nuk kemi mund me i fillue as procedurat për dhënie, ose marrje. Gjithmonë para juve, kur është bërë prezentimi është treguar edhe plani dinamik sepse është kriter i veçantë. Ne pa vërtetimin tatimor nuk mundemi me ia pranue dokumentet në kadastër, pa qarkullimin bankar deri në 1,000 faqe komplet i kemi printue dhe i kemi dërgue më heret. Mirëpo,

materialin nuk e kanë shikue dhe këtë e them me përgjegjësi të plotë nga ana e Ministrisë, e jo nga ana jonë. Asnjë lajthitje në këtë drejtim nuk ka sepse unë flas me dokumente.

Kryesuesi – Unë nuk merrem me çështje teknike si kryesues sepse çështjet teknike i rregullon DPUKP-ja. Këto, dokumente që iu kanë munguar vendimeve nuk është mirë sepse ne kemi marrë vendim si Kuvend.

Lulzim Sadiku – Kjo po na përsëritet shumë herë, ose pothuajse për çdo vit dhe 9 vendime me u kthye, vërtetë është për me përgëzue kryesuesin, zyrtaren ligjore, drejtorët, brilantë janë. Kjo, nga fakti se ne nuk po kemi të drejtë kur po i kritikojmë se po e merrni anën e kundërt negative, ose është dashur me qenë falenderues. Vërtetë, shumë herë e kam ngritë zërin dhe sikur të isha kryesues 9 vendime me u kthye, nuk e di a do të isha pjesë më e kryesuesit sepse 9 vendime me u kthye prapa, kryesues, nuk di se çfarë komenti më duhet. Ju jeni drejtorët më të mirë që ekzistoni, keni zyrtaren ligjore që nuk përgjegjet asnjëherë sepse po të ishte përgjegjë zyrarja ligjore 9 vendime me u rishikue vërtetë, më vjen keq prej Kryetarit Gashi, që me këtë staf punon. Unë në mënyrë proteste do ta lëshoj takimin sepse nuk do ta bëjë këtë rishikim, sepse kjo punë nuk don koment. Do të ishte mirë sikur të ishte Kryetari këtu, që vërtetë me bisedue pak më gjatë për këtë çështje. Unë do ta lëshoj takimin për shkak se nuk marrë pjesë në këto rishikime të 9 vendimeve. Ministria, me siguri ajo ka faj që ju jeni shumë të mirë dhe ata nuk i dijnë gjërat që i kthejnë vendimet prapa.

Kryesuesi – Singerisht, isha habitë mos me qenë ti, por kurrë në jetën tënde nuk ia ke qëlluar, më vjen keq. Unë thashë në fillim se kemi marrë vendim politik, por gabimi ka qenë të çështjet teknike, që nuk i ka përcjellë administrata. Mirëpo, po ta them një gjë se në jetën tënde kurrë nuk ia ke qëllue, sepse ata që punojnë edhe gabojnë. Ne kemi marrë vendime, dhe unë ashtu qysh merrë Vendim Kuvendi edhe e nënshkruaj, por gabim teknik ka ndodhë, që të gjitha dokumentet nuk janë futë në lëndë. Pra, ka qëllue fushatë dhe nuk ka pasë komunikim hiç Ministria. Në vitin 2020, ka ardhë vetëm një vendim i vitit 2019 me rishikue dhe asnjë vendim tjetër nuk e kemi pasë, ndërsa në vitin 2019 kemi pasë 13, ose 14 vendime në rishikim.

Lulzim Sadiku – Unë nuk e përmenda vitin 2019 dhe sa herë ka pasë rishikime, gjithmonë kam qenë kundër vendimeve të paligjshme. Unë në emër të grupit dhe si Kryetar partie, kisha kërkue me dhënë dorëheqje sepse ti nuk je i aftë më këtu, me udhëheqë. Seriozisht je njeri që 9 vendime duhet me u rishikue, ti duhet me dhënë dorëheqje me ua humbë njerëzve tretmanin si përgjegjës i Kuvendit.

Pas këtyre diskutimeve z.Lulzim Sadiku, e lëshoi mbledhjen.

Shqip Paloja – Unë mendoj se z.Lulzim Sadiku, nuk ka faj që doli sepse para pak minutave e vuri në lajthitje komplet këtë Kuvend komunal dhe votuam kundër një propozimi të Kryetarit të Komunës, që të shpallen zona me interes publik pasuritë shoqërore. Mirëpo, edhe nëse, ne i kishim shpallë zona me interes publik edhe nëse janë privatizue ato, ne kemi përparësi dhe më vjen keq që z.Lulzim Sadiku doli, por ai nuk ka faj, ju keni faj dhe unë votova kundër. Ai delë këtu dhe deklaroi shumë gjëra të pavërteta.

Fatmir Bekteshi – Unë e kam një vërejtje për kryesuesin, ose nuk jam i njoftuar mirë se qysh shkojnë këto procedura, ata aplikues që vijnë nuk di a aplikojnë në Drejtorinë e administratës, apo në Drejtorinë e kadastrit dhe çfarë është ky problem. Vetëm se nuk është prezentë këtu, mos e gjuaj topin dikund tjetër sepse ata kur kanë ardhë me aplikue këtu, i kanë pikat se çka duhet prej dokumenteve. dhe ne nuk e kemi atë përgjegjësi me shikue se a i ka sjellë ai apo nuk i ka sjellë dokumentet. Ne vetëm kemi me marrë vendim.

Kryesuesi – Përgjegjësia është direkt te DPUKP-ja, por administrata përfshihet krejtë sepse lënda duhet të kompletohet. Unë asnjë lëndë nuk e kam parë derisa na e kanë dërguar dhe për shkak të gabimeve teknike vendimet duhet të rishikohen.

Aziz Bici – Mua, më vjen keq që z.Arben Berisha, nuk e pranoi përgjegjësinë dhe po quhen gabime teknike. Unë dyshoj se këto janë vetëm gabime teknike dhe mendoj që janë tentime për të mundur konkurrencën. Unë nuk besoj se kompanitë kanë mundë të bëjnë gabime për shkak se ata janë të vetdijshëm se çfarë kriteresh kërkohen. Poashtu, nuk besoj se nuk keni staf të mjaftueshëm në Drejtoritë përkatëse, duke e përfshirë edhe zyren për çështje ligjore, që të shmangin lëshimin e të gjitha këtyre gabime. Unë kërkoi prej

juve, që në seancën e ardhshme të bëhet një sqarim me shkrim nga DPUKP-ja, në mënyrë që ne të dijmë se për çfarë arsye bëhen këto lëshime, a është faji te ju, a është faji në Ministri, apo ku është faji.

Hysni Mjeku – Kryesues, unë e kam një vërejtje se për këtë që po diskutojmë tash këtu, nuk është dashur me ardhë në këtë seancë sepse nuk ka kaluar përmes KPF-së. Çdo lëndë duhet të kalojë përmes KPF-së, dhe nuk është dashur me na sjellë në këtë gjendje sepse disa akuza që u thane këtu, nga kolegët vërtetë, nuk qëndrojnë nga se ne me përkushtimin më të madh iu kemi qasë këtyre problemeve. Nëse, është në pyetje mungesë e dokumentacionit psh nuk është dashur me ardhë në rishikim sepse vendimin veç e kemi marrë dhe lënda duhet të kompletohet, e të dërgohet në Ministri. Ne vendim kemi marrë dhe pse tash me rishikue nëse, psh ka mungue vetëm një vërtetim sepse ana teknike i mbetet Drejtorisë me kompletue lëndën. Prandaj, ne nuk duhet të akuzohemi këtu, në mes veti për gjëra teknike sepse ka kalue përmes KPF-së dhe KPF-ja, e ka filtrue çështjen.

Kryesuesi – Unë komunikimin e fundit që e kam pasë me Ministrinë, ka qenë kjo fjali se te lëndët i keni pasë dhe nëse, i ka munguar lëndës ndonjë dokument kanë mund me bë kërkesë dhe me marrë dokumentin, e jo me na i kthye 9 vendime në rishikim. Këto vendime na i kanë kthye në rishikim dhe unë obligohem ligjërisht me i rishikue.

Ibush Mjekiqi – Këto vendime nuk janë të paligjshme, por janë kthye në rishikim për shkak të disa lëshimeve në procedurë. Nëse, ju doni me votue sot mirë, e nëse jo absolutisht nuk paraqet problem që të shtyhen për seancën e radhës dhe le të kalon edhe përmes KPF-së, të merren informatat shtesë nga Drejtoria përkatëse. Ne këtu, asnjëri nuk jemi mbi tjetrin, por është çështja e edukatës se nuk mund të ia japim edukatën askujt dhe me dalë këtu e me bë kualifikime të panevojshme. Mua, më vjen keq që personi që foli nuk është këtu, por nuk mundet me na kualifikue ai sepse këtu jemi 40 vetë. Propozoj që kjo çështje të shtyhet për seancën e ardhshme, të plotësohet dokumentacioni, dhe të kalojë përmes KPF-së.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ta shtyejmë këtë çështje për seancën e ardhshme.

Hysni Mjeku – Edhe ne jemi për atë që ta shtyejmë këtë çështje për seancën e ardhshme.

Aziz Bici – Unë kam kërkuar sqarim me shkrim pse po vijnë këto vendime kështu.

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, atëherë rishikimi i këtyre vendimeve me pëlqimin tuaj shtyhet për mbledhjen e ardhshme, pasi e kemi afatin ligjor 30 ditë, prej datës që i kemi marrë.

Pika e 9 e rendit të ditës

Armend Rushiti – Për fshatin Bakshi, që pyeta më heret çka ka ndodhë me tokën që është shpallë me interes publik nga Kuvendi komunal.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se është procedurë tjetër për këmbim të pronës shoqërore me pronën private dhe ne nuk kemi heqë dorë. Pra, janë procedurat për zgjidhjen e këtij konflikti për ndërtimin e një fushe sportive. Është vetëm Komisioni ministror, Komisioni për asete që e bën vlerësimin dhe ne asnjëherë nuk kemi heqë dorë nga kjo çështje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:12'

Bashk. prof. për punë të KK

Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal

Burim Gërguri